

## **Instituti i Financave i Kosovës “IFK” – Pejë**

**Konzorciumi Ndërkombëtar i Ekspertëve të Biznesit dhe Punësimit – Prishtinë**

### **Raport i punës së Konferencës së Tretë Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi nga tematika “Roli i investimeve në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e punësimit në Kosovë dhe në vendet tjera në tranzicion”, mbajtur me 19 nëntor 2004 në Pejë**

Këtë konferencë e organizoi *Instituti i Financave i Kosovës* në bashkëpunim me *Konzorciumin Ndërkombëtar të Ekspertëve të Biznesit*, me përkrahjen financiare të *Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert Stiftung*.

Gjatë përgatitjes së kësaj konference u zhvilluan kontakte nëpërmes postës elektronike me më se 100 ekspertë të vendeve të ndryshme të ftuar për pjesëmarrje me punimet e tyre në këtë konferencë. Këta ekspertë i dhanë përkrahje të rëndësishme tematikës dhe objektivave të kësaj konference.

Programi i kësaj konference iu prezentua institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të cilat zgjuan interesim të veçantë për punimet e saj, veçmas u zhvilluan diskutime me drejtorin e zyrës së Bankës Botërore në Prishtinë, me ekspertët e UNDP-së dhe institucione tjera. Ky program u diskutua edhe me ekspertët e administratës qendrore dhe lokale në Kosovë dhe në disa vende tjera në tranzicion.

Në përgatitjen e kësaj konference kontribut i veçantë dhanë ekspertët e Konzorciumit Ndërkombëtar të Ekspertëve të Biznesit dhe Punësimit i formuar në Konferencën e Dytë Biznesi dhe Punësimi të mbajtur në tetor të vitit 2003 në Pejë.

Në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi me tematikë “Roli i investimeve në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e punësimit në Kosovë dhe në vendet tjera në tranzicion”, mbajtur me 19 nëntor 2004 në Pejë u prezentuan 23 punime shkencore të autorëve nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Bullgaria, Sllovakia, Kroacia dhe Bosnja.

Konferencën e përshëndetën mysafirë të institucioneve të ndryshme nga administrata qendrore dhe lokale, përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale së Kosovës, Ministrisë së Shërbimeve Publike së Kosovës, përfaqësuesit e Bankës Private të Biznesit, të Odës Ekonomike të Kosovës, të Agjencisë së Investimeve të Jashtme në Ekonominë e Kosovës, përfaqësuesit e Universitetit të Tiranës, të Universitetit të Shkodrës, të Universitetit të Vlorës, të Universitetit të Sarajevës, të Universitetit të Prishtinës, përfaqësuesi i Qendrës së Zhvillimit të Ulqinit etj.

Në këtë konferencë morrën pjesë 50 pjesëmarrës, të cilët ishin autorët e punimeve, ndërmarrësit dhe menaxherët e kompanive publike, shoqërore dhe private, përfaqësues të Organizatave Joqeveritare vendore dhe të jashtme.

*Referatin hyrës me temën “Roli i investimeve në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e punësimit në Kosovë dhe në vende tjera në tranzicion” e paraqiti Prof. Dr. Isak Mustafa, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv i Institutit të Financave të Kosovës dhe profesor në Fakultetin e Biznesit në Pejë, Universiteti i Prishtinës.*

**Konferenca i zhvilloi punimet në tri sesione. Në sesionin e parë me tematikë “Investimet në funksion të zhvillimit të biznesit dhe punësimit” u paraqitën 11 punime siç janë: Roli i kulturave në nivelin e investimeve, Investimet në ndërtimin e hidrocentraleve në grykën e Lumit Ereniku, Roli i investimeve në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe**

të mesme në Bullgari, Nxitësit financiarë dhe jofinanciarë dhe influenca e tyre në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, Ndikimi i investimeve në zhvillimin e zonave rurale, Prioritetet e investimeve në Kosovë, Roli i organizatave joqeveritare në zhvillimin e investimeve në bizneset atraktive për rritjen e punësimit, Reforma e arsimit në funksion të zhvillimit të bizneseve dhe rritjes së punësimit, Problemet demografike në lidhëshmëri me biznesin dhe rritjen e punësimit, Globalizimi, integrimet ekonomike regionale dhe investimet e huaja direkte, Roli i investimeve në zhvillimin e turizmit rasti i rajonit të Shkodrës.

*Në sesionin e dytë me tematikë “Roli i bankave dhe menaxhimi i investimeve në zhvillimin e bizneseve dhe rritjen e punësimit” u paraqitën 11 punime siç janë: Roli i bankave në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, Roli i bankave në zhvillimin e biznesit dhe punësimit në Kosovë, Administrata lokale dhe përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kroaci, Eksperienca e privatizimit në vendet e Evropës Juglindore, Rëndësia e procesit të rafinerimit nga mezoproduktet e plumbit në zhvillimin e metalurgjisë dhe punësimit në Kosovë, Prezentimi i projektit të trajnimit për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të reja në viset rurale në kushtet e ekonomisë në tranzicion, Investimet në bizneset turistike të Bosnjës, Prezentimi i rezultateve të projekteve të përkrahjes së zhvillimit të bizneseve të ekonomisë lokale, Investimet në bizneset bregdetare në Mal të Zi, Rëndësia e kredidhënies në rritjen e investimeve.*

*Në sesionin e tretë me tematikë “Përfundimi i konferencës” janë aprovuar 13 konkluzat dhe fjala përfundimtare me rastin e mbylljes së konferencës.*

Konkluzat përmbajnë tematikë përmbledhëse të punimeve dhe diskutimeve me karakter rekomandues të drejtuara strukturave të administratës qendrore dhe lokale, institucioneve financiare dhe bankare, ndërmarrësve dhe menaxherëve të kompanive të veprimtarive të ndryshme në drejtim të zhvillimit të biznesit dhe rritjes së punësimit në Kosovë dhe në vende tjera në tranzicion.

Kërkesa e pjesëmarrësve të kësaj konference është që Instituti i Financave të Kosovës, Konzorciumi Ndërkombëtar i Ekspertëve të Biznesit dhe Punësimit si dhe Agjencia e Investimeve të Jashtme në Ekonominë e Kosovës të angazhohen së bashku me institucionet tjera nga vendet e zhvilluara dhe në tranzicion për implementimin e konkluzave të kësaj konference.

Puna e konferencës u prezentua në mjete të ndryshme të informimit siç janë gazetatat ditore: Bota Sot, Epoka e Re, pastaj në medime të ndryshme si: Radio Kosova, Radio Dukagjini, Radio Peja etj.

Në Radio Televizionin e Kosovës “RTK” dhe në Televizionin e Dukagjinit u prezentuan emisione të veçanta kushtuar punës së kësaj konference ku morrën pjesë disa autorë të punimeve nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe gazetarët zhvilluan biseda me disa autorë të punimeve të kësaj konference.

Puna e Konferencës së Tretë rezultoi me realizimin e objektivave dhe tematikave të parapara në programin e kësaj konference.

Raportin e sajoi:

Prof. Dr. Isak Mustafa, Kryetar i Këshillit Përgatitor

Pejë, 03.12.2004